




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Primijshe/Prodato Received/Delivery	17-03-2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SLIMSHUK	2791	2023	114



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.268/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arditë Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyl Bektëshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.268/2023 të datës 30.01.2023 të parashtruar nga ankuesi në çështjen juridike "kontestim konkursi", në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 16.03.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.268/2023 të datës 30.01.2023, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 30.01.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1071/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me shenjen A.nr.268/2023, kundër Vendimit Nr.73/2023 të datës 16.01.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike lidhur me dokumentet e aplikimit si dhe mos shqyrtimit dhe mos verifikimit të dëshmive të parashtruara me rastin e parashtrimit të ankesës në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 06.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë. ndërsa kjo e fundit me datë 16.02.2023, ka dërguar shkresat lidhur me çështjen në procedurw.

Më Vendimin me numër protokolli 2545/2023 të datës 09.03.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vazhduar afatin për vendosje të ankesës A.nr.268/2023 të datës 30.01.2023 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 30.01.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetimin me Nr.141/22 të datës 22.11.2022; Kontratën e punës me Nr.11/26 të datës 07.04.2015; Vendimi numër 73/2023 i datës 16.01.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, Pasqyra e llogarisë (Trusti); Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 06.02.2023; Përgjigja në ankesë e datës 16.02.2023; Konkursi i datës 02.11.2022 me numër reference; RN00010341; Vendimi me Nr.15/99 i datës 30.09.2022; Lista e aplikanteve në pritje; Lista e kandidateve të aprovuar; Lista e kandidateve të refuzuar; Njoftimin e datës 06.01.2023 për kandidatet në listë të ngushtë; Njoftimin e datës 24.01.2023 plotësim ndryshim i listës së ngushtë; Vendimin me Nr.124/2023 i datës 06.01.2023; Ankesën e parashtruar nga ankuesi në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i datës 10.01.2023; Aplikacionin e datës 01.12.2022; Diplomën me numër 1011-1428/1 të datës 16.05.2022; Diplomën me Nr.995 të datës 12.12.2018; Certifikatën për përfundimin e trajnimit Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në arsimin parauniversitar të vitit tetor 2019; Diplomën M.Gashi; Certifikatën për përfundimin e trajnimit Prishtinë 2019; Certifikatën e datës maj 2018; Certifikatën e datës 10.01.2011; kopje e Letër-njoftimit të ankuesit; Vlerësimin për mësimdhënësin i vitit shkollor 2021/2022; Vlerësimin për mësimdhënësin i vitit shkollor 2020/2021; Vërtetimin me Nr.147/22 i datës 25.11.2022; Certifikatën nga evidenca penale e datës 17.11.2022; Deklaratën e datës 23.11.2022; Vendimin me numër protokoll 2545/2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër A.nr.399/2023 të datës 15.03.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 15.02.2023 i nxjerrë nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme; e-mailin e datës 27.02.2023 nga A.P për A.K dhe 03.03.2023 të A.K për A.P.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, konstatoi që të përfundoj procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.268/2023 të datës 30.01.2023, *sepse:*

Nga shqyrtimi i provave të çështjes, Kolegji ka konstatuar se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 02.11.2022 ka shpallur konkursin e jashtëm me numër reference RN00010341 për grupin e pozitës *Specialist i Shkencave Shoqërore/ Inspektor i Arsimit*, në Inspektoratin e Arsimit, i hapur për aplikim nga data 23.11.2022 deri me datë 07.12.2022. Në konkursin në fjalë kishte aplikuar edhe ankuesi, mirëpo në fazën e shqyrtimit paraprak, Njësia Përgjegjëse/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin e Nr.124/2023 të datës 06.01.2023 ka refuzuar aplikacionin e ankuesit për shkak se i njëjti nuk ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara sipas konkursit respektivisht kopjen e dëshmisë së punësimit.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi me datë 10.01.2023, ka paraqitura ankesë kundër Vendimit Nr.124/2023 të datës 06.01.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ndërsa ky i fundit me Vendimin Nr.73/2023 të datës 16.01.2023, ka refuzuar ankesën e ankuesi si të papabazuar, po me arsyetimin se ankuesi nuk ka dorëzuar dokumentet e kërkuara sipas konkursit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, preton se me rastin e ngarkimit të dokumentit kishte ndodhur gabim teknik ku në vend të çerkatës nga gjykata ka ngarkuar një dokument tjetër.

Ankuesi brenda afati ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.73/2023 të datës 16.01.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike lidhur me dokumentet e aplikimit si dhe mos shqyrtimit dhe mos verifikimit të dëshmive të parashtruara me rastin e parashtrimin të ankesës në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, duke kërkuar anulimin e vendimit të kundërshtuar me ankesë dhe që lënda të kthehet në rishqyrtim.

Po nga provat e lëndës, Kolegji ka gjetur se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, përkundër ankesës se ankuesit kishte vazhduar me procedurën sipas konkursit të jashtëm me numër reference RN00010341, me ç'rast përmes njoftimit të datës 15.02.2023 ka bërë anulimin e konkursit për grupin e pozitës "Specialist të Shkencave Shoqërore-Inspektor i Arsimit", kurse në përgjigje të kërkesës së Këshillit, përmes emailit të datës 03.03.2023, ka informuar Kolegjin se, citoj "Sipas kërkesës suaj, ju njoftojmë se anulimi i konkursit për grupin Specialist të Shkencave Shoqërore....., ka ndodhur për shkak të gabimeve përmbajtjesore në kriteret e konkursit, për këtë arsye është parë e nevojshme të anulohet kjo procedurë".

Kolegji i Këshillit thekson faktin se kundër Njoftimit të datës 15.02.2023 për anulim të konkursit të jashtëm me numër reference RN00010341, për grupin e pozitës "Specialist të Shkencave Shoqërore-Inspektor i Arsimit", kandidati Artan Haradinaj me datë 22.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër A.nr.399/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli duke vendosur sipas ankesës A.Nr.399/2023 të datës 22.02.2023, ka shqyrtuar ligjshmërinë e anulimit të procedurës sipas Konkursit me numër reference RN00010341 dhe më Vendimin me numër A.nr.399/2023 të datës 15.03.2023 ka refuzuar ankesën me numër A.nr.399/2023 të datës 22.02.2023, duke lënë në fuqi Njoftimin e datës 15.02.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pasi që në vlerësimin e Këshillit, procedura e zhvilluar sipas konkursit me numër reference RN00010341 është përfshirë me shkelje procedurale dhe materiale, kështu që anulimi i kësaj procedurë është konsideruar i bazuar dhe i ligjshëm.

Andaj, duke qenë se objekti i ankesës A.nr.268/2023 i datës 30.01.2023 ka të bëjë me procedurën e konkursit me numër reference RN00010341, për grupin e pozitës "Specialist të Shkencave Shoqërore-Inspektor i Arsimit", e cila procedurë është anuluar nga njësia përgjegjëse dhe meqenëse Këshilli me vendim meritator ka lënë në fuqi njoftimin për anulim të datës 15.02.2023, Kolegji konstaton se objekti i ankesës A.nr.268/2023 është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje, dhe si rrjedhojë në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot*, vendosi që të përfundoj procedimin administrativ i filluar sipas ankesës së ankuesit

Përmbledhur si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt



administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.268/2022

Avdyll BEKTESHI

Avdyll Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/MPB dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së

